



Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

Fjalim nga Ambasadori Osmo Lipponen, Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri,
në hapjen e tryezës mbi Çështjet e Medias Shqiptare Sot

Hotel Rogner Europapark, Tiranë, Shqipëri
7 korrik 2004

Zonja dhe zotërinj,

Dëshiroj t'ju uroj mirëseardhjen të gjithëve në këtë tryezë në emër të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Ne punojmë aktivisht në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të institucioneve të medias shqiptare dhe legjislacionit, harmonizimit të standarteve vendase të medias me ato evropiane, forcimit të medias së pavarur dhe institucioneve të medias, kultivimit të lirisë së medias së përgjegjshme dhe përkrahjes së praktikës së gazetarisë së mirë.

Me qëllim që të realizojë këto objektiva të përgjithshme, Prezenca mban një dialog të hapur me institucionet përkatëse shqiptare. Ajo bashkëpunon, gjithashtu, ngushtësisht me institucionet ndërkombëtare për të siguruar ekspertizë për çështjet e medias.

Ne besojmë se media mund të kontribuojë ndjeshëm në drejtim të ndryshimeve pozitive në Shqipëri, dhe, në disa raste, media ka luajtur me të vërtetë një rol konstruktiv. Është inkurajuese të shohësh se media elektronike po investon aftësitë e saj profesionale për të prodhuar programe të reja shqiptare, që pronarët po investojnë në mënyrë të konsiderueshme në teknologji dhe që respektimi i ligjit për të drejtën e autorit është rritur ndjeshëm.

Por, megjithë këto zhvillime, ka ende vend për përmirësim në median shqiptare. Midis temave të kësaj tryeze, ne shohim një varg çështjesh me të cilat media shqiptare po përballet për momentin.

Më lejoni të prek disa prej këtyre çështjeve:

Së pari, çështja e transparencës. Shoqëria shqiptare ka nevojë për rritjen e transparencës. Në rastin e medias, strukturat e pronësisë së kompanive të medias duhet të jenë të qarta.

Politika editoriale nuk duhet të diktohet vetëm nga interesat e ngushta të pronarëve, politikanët që mbështesin apo reklamuesit e fuqishëm. Redaksitë kanë nevojë për më shumë pavarësi nga marrëveshjet e biznesit të pronarëve me politikanët në këmbim të mbrojtjes, tenderave me fonde publike apo kontratave të majme të reklamave. Media është pushteti i katërt.

Gazetaria është një profesion i nderuar dhe i përgjegjshëm. Fatkeqësisht, shumë gazetarë vazhdojnë të punojnë në tregun e zi, pa të drejta të garantuara nga Kodi Shqiptar i Punës.

Publiku shqiptar ka shprehur opinionin e tij mbi atë që ndodh me median sot. Jam informuar se shifrat e tirazhit të gazetave kanë rënë në mënyrë të ndjeshme dhe se njerëzit janë shumë skeptikë në drejtim të së vërtetës të paraqitur në media. Media bën pjesë në biznesin e besueshmërisë dhe, nëse besueshmëria humbet, gazetaria pushon së qeni një biznes dhe shndërrohet në armë.

Kohët e fundit, ju keni diskutuar disa çështje në lidhje me legjislacionin e medias dhe, në veçanti, projektligjin për median e shkruar. Ne po e ndjekim nga afër se si po përgatitet ky projektligj dhe do të bëjmë komentet tona me përfundimin e tij.

Legjislacioni për shpifjen ka nevojë të çkriminalizohet. Deklarata e Londrës e vitit 2000 për Sfidat Aktuale të Lirisë së Shtypit thekson se shfuqizimi i ligjeve penale për shpifjen në favor të ligjeve civile duhet marrë në konsideratë, në përputhje me standartet përkatëse ndërkombëtare. Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Shtypit tha në vitin 2002 se asnjë mbrojtje e veçantë nuk duhet t'iu jepet zyrtarëve publikë, të cilët duhet të ushtrojnë një nivel më të lartë tolerance ndaj kritikave se sa qytetarët e zakonshëm. Ai shtoi se asnjë gazetar nuk duhet të dënohet me burgim për atë që shkruan dhe se, në një demokraci, të shkruash për veprimtaritë e nëpunësve publikë është pjesë e detyrave profesionale të gazetarit.

Ne mbështesim të gjitha iniciativat për mbrojtjen e lirisë së shprehjes në legjislacion, por edhe ato të vetërregullimit që vijnë nga vetë komuniteti i mediave. Punonjësit e medias duhet të sjellin më shumë profesionalizëm, pavarësi dhe përgjegjshmëri në punën e tyre. Për momentin, mekanizmat e vetërregullimit në Shqipëri janë ende në një fazë fillestare. Kodi i Etikës ka nevojë të rishikohet. Media duhet të kuptojë se liria vjen bashkë me përgjegjësinë dhe, nëse ky dyzim nuk është simetrik, media nuk mund t'ia hedhë fajin të tjerëve për çdo gjë.

Prezenca e OSBE-së, në bashkëpunim me organizatat e saj partnere, do të vazhdojë t'i ofrojë asistencën dhe ekspertizën e saj medias shqiptare dhe institucioneve përkatëse të medias, sa herë që të jetë nevoja, dhe do të vazhdojë të nxisë lirinë e shprehjes, të shoqëruar me përgjegjshmërinë.